



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 2396 prot.

Fushë-Arrëz, më 08.08.2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. 26 datë 08/08/2025

**“ PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE
DIASPORËN 2025—2028”**

Këshilli bashkiak Fushë-Arrëz, në mbledhjen e datës ___/___/2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, në nenin 29/1 të ligjit 38/2019 Për disa shtesa në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 54 pika (k); ligjin Nr.113/2020 “Për shtetësinë”; ligjin Nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar; ligji Nr.79/2021 “Për të huajt, si dhe në relacionin e administratës së Bashkisë Fushë-Arrëz;

VENDOSI:

1. Miratimin e planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028 sipas materialit bashkëlidhur;
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Koordinimit të Projekteve, Integrimit Evropian dhe Migracionit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 të ligjit Nr.139/2015.

Spec. i Migracionit dhe Diaspores

Marie MORINAJ

Juriste

Redona HASANI

KRYETARI

Hil CURRI

Adresa: Rr. Qendër Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 2396/ prot.

Fushë-Arrëz, më _____._____.2025

PËR: KËSHILLIN BASHKIAK

FUSHE-ARRËZ

RELACION MBI PROJEKTIN PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR
MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2025—2028

Bashkia Fushë-Arrëz, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj në fushën e diasporës dhe migracionit, ligjit "Për veteqeverisjen vendore, i ndryshuar Neni 29/1 dhe akteve nënligjorë të tij, Strategjise Kombëtare për Diasporën Shqiptare, ligjit "Për te huajt", ligjit "Për shtetësinë", ligjin nr. 16/2018 "Për diasporën", i ndryshuar; hartoi grupi i punës (Programi Migrimi dhe diaspora), draftin e "Planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028".

Ky dokument është i një rëndësie të veçantë, duke marrë parasysh situatën aktuale, në të cilën nga njëra anë kemi migracionin gjithnjë në rritje drejt vendit tonë, si dhe migrantët e kthyer, si një komunitet me nevoja emergjente, të cilit duhet të kushtohet vëmendja e duhur për të arritur një ri-integrim të qëndrueshëm të tij, nga ana tjetër qëndron diaspora, e cila është një resurs i jashtëzakonshëm intelektual dhe ekonomik, si dhe potencial konkret për zhvillimin e vendit.

Diaspora e Fushë-Arrëzit është një mundësi e madhe për zhvillimin e vendlindjes. Ky Plan veprimi synon të mbështesë organizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, në mënyrë që të përmirësohet kapaciteti i Diasporës.

Qëllimi është që ajo të mund të luajë rolin e një partneri të rëndësishëm strategjik për të ardhmen e vendlindjes. E gjithë kjo do të realizohet me një proces rivlerësimi të marrëdhënies me Diasporën si një faktor, i cili do të ushtrojë ndikimin e vet në qytetin e origjinës dhe anasjelltas.

Sa më sipër "Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028", përbën një plan masash konkrete, të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e migracionit dhe diasporës, të cilat garantojnë permbushjen e projekteve prioritare për integrimin e tyre dhe përfshirjen në jetën social ekonomike të Bashkisë Fushë-Arrëz.


Me miratimin e këtij plani synohet gjithashtu incentivimi i investimeve nga diaspora në komunitetet e tyre të prejardhjes, si dhe organizatave ndërkombëtare, nëpërmjet implementimit të projekteve të përbashkëta, me qëllim zhvillimin social-ekonomik të qytetit.

"Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028" është një dokument i rëndësishëm, i cili pasqyron detajimin e funksioneve bazë të sektorëve të ndryshëm të bashkisë, për permbushjen e detyrave të saj funksionale, duke e shëndrruar bashkinë në një portë të hapur për angazhimin dhe përfshirjen e diasporës së Fushë-Arrëzit në jetën ekonomike dhe social-kulturore të qytetit, si dhe një suport dhe ndihmë konkrete për migrantët e kthyer.

Duke kërkuar mbështetjen tuaj.

Spec. i Migracionit dhe Diaspores

Marie MORINAJ



K R Y E T A R I

HiL CURRI

